

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Fillim Skoro, kryetar, Have Haliti dhe Xhevdet Abazi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.H., nga ..., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit N.H., av. Q.R., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.71/18, të datës 01.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datë 14.02.2019, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit N.H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.71/18, i datës 01.11.2018, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.71/18, të datës 01.11.2018, i akuzuari N.H., është shpallur fajtor për veprën penale lëndimi lehtë trupor, nga neni 189 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së, dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6 (gjashtë)muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.07.2018 deri më datë 01.11.2018.

I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50(pesëdhjetë)€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave shumën 50(pesëdhjetë) €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Pala e dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarit ti shqiptoj dënim me burg më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.H., av.Q.R., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më butë ose dënim me kusht.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/I.nr.17/19, të datës 11.01.2019, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore si e bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit N.H., av.Q.R., të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, av. Q.R., janë të pa bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar prishjen e aktgjykimit dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, se me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par.2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoj vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Prokuroria në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, mirëpo, me rastin e shqiptimit të dënimit ka nxjerrë konkluzion të gabuar pasi që dënimi i tillë është i butë në krahasim me veprën e kryer penale, se gjykata me rastin e vendosjes së dënimit pati parasysh vetëm rrethanat lehtësuese, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur, por që është dashur të ketë parasysh dhe të marrë për bazë rrethanat rënduese si shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, faktin se në rastin konkret i akuzuari i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor të dëmtuarit në dorën e majtë si dhe në pjesë të ndryshme duke i shkaktuar thyerjen e kockave të parakrahut të dorës së majtë, e që bëjnë pjesë në lëndimet e rënda trupore, se i akuzuari është i njohur për kryerjen e veprave penale kundër të dëmtuarit dhe familjes së tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.H., në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese, si pajtimin e të akuzuarit me të dëmtuarin, është penduar, pranimin e fajësisë, se familja e të akuzuarit i ka bartur të gjitha shpenzimet e mjekimit për të dëmtuarin kështu duke bërë në një formë edhe kompensimin e dëmit të dëmtuarit, se në rastin konkret viktimë më e madhe është vet i akuzuari, se është viktimë e rrethit ku jeton dhe e kodit penal pasi që veprimet e tij dhe pasojat e shkaktuara nuk korrespondojnë me politikën e dënimit.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen më nuk do të kryej vepra penale, kërkim faljen ndaj familjes, sjelljen e të akuzuarit në gjykatë dhe në procedurat tjera, moshën e të akuzuarit, sjelljen e tij pas konfliktit, se vepra penale nuk ka qenë e planifikuar dhe se ka ndodhur papritmas, se i akuzuari është familjar dhe baba i dy fëmijëve, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë i aprovon rrethanën lehtësuese që ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit, se i akuzuari ka pranuar fajësinë, e që në veti përfshinë vetëdijësimin e të akuzuarit se ka kryer një veprë penale, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, se është penduar për veprën e kryer, më parë nuk ka qenë i dënuar, mbrojtësi i të akuzuarit A. në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë nga ato rrethana që ka i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë. Theksimet e mbrojtësit të akuzuarit në ankesë janë rrethana të përgjithësuara, që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit, e për këtë i ka aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit, atëherë kjo gjykatë gjen se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë pretendimet të bazuara, kurse pretendimet e prokurorisë se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, faktin se në rastin konkret i akuzuari i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor të dëmtuarit në dorën e majtë duke i shkaktuar thyerjen e kockave të parakrahut të dorës së majtë e që bëjnë pjesë në lëndimet e rënda trupore, sipas kësaj gjykate janë elemente të veprës penale, se i akuzuari është i njohur për kryerjen e veprave penale, këtë fakt prokuroria nuk e ka argumentuar me prova materiale, andaj kjo gjykatë gjenë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Vlerësimet e këtilla të gjykatës se shkallës së parë, i pranon edhe kjo gjykatë, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikojë edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 401 të KPPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.3/19, të dt.14.02.2019**

Procesmbajtësi,  
Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit  
Fillim Skoro

1. Have Haliti
2. Xhevdet Abazi